

## **Top Channel sha**

(te gjitha vlerat ne Lek, pervec nese nuk shprehet ndryshe)

### **1. Informacion i përgjithshëm**

Top Channel sh.a. ("Shoqëria") eshte një kompani aksionere, e cila është krijuar ne vitin 2001 me vendim gjykate Nr. 25561 datë 29.03.2001. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatese te ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtaret dhe Shoqërite tregtare" dhe nga statuti i saj. Adresa e selisë së shoqerisë është Rruga 17 Nentori, Godina nr.2 Kashar.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie eshte në fushen e veprimitarisë televizive kombëtare që përfshin prodhimin, transmetimin e programeve te informacionit të çdo lloji me anë te zërit dhe figurës, sinjaleve te koduara, dhe shkrimit te destinuara per publikun.

Veprimtaria radiotelevizive zhvillohet në përputhje me ligjin nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, me dispozitat e ligjit Nr. 8410, datë 30.9.1998 PËR RADION DHE TELEVIZIONIN PUBLIK E PRIVAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Perfaqësues Ligjor i shoqerisë Top Channel sh.a është znj. Vjollca Hoxha. Shoqëria më 31 dhjetor 2019 kishte 441 punonjës të regjistruar (31 dhjetor 2018: 470).

Struktura e aksionerëve të shoqerisë si më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2019</b>	<b>31 Dhjetor 2018</b>
	%	%
Vjollca Hoxha	20%	20%
Lorela Hoxha	20%	20%
Itan Hoxha	20%	20%
Sara Hoxha	20%	20%
Redia Hoxha	20%	20%
<b>Total</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

### **2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)**

#### **2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale**

##### **Adoptimi i SNRF 16 "Qiratë"**

SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019). Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen, prezantimin dhe paraqitjen e qirasë. Të gjitha qiratë pothuajse rezultojnë që qiramarrësi të ketë të drejtën e përdorimit të një aktivi në fillim të qirasë dhe, nëse pagesat e qirasë bëhen përgjatë kohës të marrë edhe financim. Rrjedhimisht, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qerave si qera operacionale ose qira financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm të kontabilitetit të qiramarrësit. Qiramarrësi do të kërkohet që të njohë:

- (a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, përvèç nese aktivi në fjalë është me vlerë të vogël; dhe
- (b) zhvlerësimin e aktiveve të marra me qira veç nga interesit për detyrimet e qirasë financiare në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

SNRF 16 në thelb ka të njëjtat kërkesa me SNK 17 për trajtimin kontabël të qirave në këndvështrimin e qiradhënsit. Ndaj, një qiradhëns vazhdon të klasifikojë qiratë e tij si qira të zakonshme ose qira financiare dhe të bëjë llogaritjet bazuar në llojin e qirasë.

## **Top Channel sha**

(te gjitha vlerat ne Lek, pervec nese nuk shprehet ndryshe)

### **2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (vazhdim)**

#### **2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale (vazhdim)**

##### **Adoptimi i SNRF 16 "Qiratë" (vazhdim)**

Shoqeria perdori disa perjashtime praktike gjate aplikimit te SNRF 16 tek qirate te cilat me pare ishin klasifikuar si qira operative sipas SKN 17. Ne vecanti Shoqeria perdori keto perjashtime si me poshte:

- nuk njobu te drejten per te perdorur aktivin dhe detyrimin per qirane per ato qira te cilat kishin maturitet me te vogel se 12 muaj qe nga data e aplikimit;
- nuk njobu te drejten per te perdorur aktivin dhe detyrimin per qirane per ato qira te cilat kishin vlere te vogel (p.sh. ato kontrata me vlere me te vogel se 5 mijë Euro ose ekivalenti i tyre ne Lek).

#### **2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende te papervetesuara**

Nje numer standardesh, amendimesh dhe interpretimesh hyjne ne perdonim per here te pare per periudhat qe fillojne ne 1 Janar 2020 ose pas kesaj date, e megjithate Shoqeria nuk i ka aplikuar keto standarde te reja ose te rishikuara ne pergatitjen e ketyre pasqyrave financiare. Asnjë standard i ri nuk pritet te aplikohet me heret nga Shoqeria.

Standarde te cilat akoma nuk kane hyre ne fuqi nuk pritet te kene ndonje ndikim material ne pasqyrat financiare te Shoqerise ne momentin e aplikimit fillestar jane si me poshte vijon:

##### **Efektive qe prej 1 Janarit 2020**

- Perditesime te Referencimeve ne Kuadrin Konceptual te standardeve SNRF
- Perkufizimi i nje Biznesi (Perditesime te SNRF 3)
- Perkufizimi i te qenit Material (Perditesime ne SNK 1 dhe SNK 8)

##### **Efektive qe prej 1 Janarit 2021**

- Kontratat e Sigurimit SNRF 17
- Shitia ose kontributi ne aktive ndermjet Investitorit dhe Bajes ose Shoqerise se Perbashket (Perditesime ne SNRF 10 dhe SNK 28)

### **3. Bazat e pergatitjes**

#### **3.1 Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare janë paraqitur të konsoliduara për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2019 duke përfshirë edhe degën e Kosoves.

#### **3.2 Baza e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") te BSNK-se. Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë.

#### **3.3 Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

#### **3.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

## Top Channel sha

(te gjitha vlerat ne Lek, pervec nese nuk shprehet ndryshe)

### **3. Bazat e përgatitjes (vazhdim)**

### **3.5. Vlerësimi dhe gjykimi**

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryej vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit finansiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabèl. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të janë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabèl që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshtuar më poshtë:

### **3.5.1. Zhylerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e klientëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësimë bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të klientëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së klientëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

### **3.5.2. Provigionet**

Provizonet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjyktimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të cdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

### **3.5.3. Zhvlerësimi i inventarëve**

Shoqëria vlerëson gjendjen e inventarit në qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera , me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit , bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe ne llogaritjen e vlerës neto të realizueshme . Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabël neto , ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar . Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

#### 4 Politikat kontabély

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

#### 4.1 Transaksionet në mopedhë të huaj

**4.1. Transaksionet në monedhë të huaj**  
Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

## **Top Channel sha**

(te gjitha vlerat ne Lek, pervec nese nuk shprehet ndryshe)

### **4. Politikat kontabël (vazhdim)**

#### **4.1. Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)**

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

<b>Kursi i këmbimit</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>
EUR/LEK	121.77	123.42
USD/LEK	108.64	107.82
CHF/LEK	112.3	109.6
GBP/LEK	143	137.42

#### **4.2. Instrumentat financiare**

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimiqit me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksi që lidhet me to, përvèç së përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten së përshkruhet më poshtë.

Një instrument finansiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit finanziar ose kur shoqëria transferon aktivin finansiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

#### **Mjetet monetare**

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

#### **Llogari të arkëtueshme**

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimiqit me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitet financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij finansiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizonit llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

#### **Llogari të pagueshme**

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Per llogarite e pagueshme ,te pa paguara dhe te pa kërkua per me shume se pese vjet per te cilat shoqeria bazuar ne te dhënat dhe komunikimin me palën tjetër nuk ka ndonjë pritshmëri per shlyerjen e këtyre detyrimeve, gjykon se detyrimet e me sipërme nuk duhen njohur si te tilla por i njeh si të ardhura te vitit që vijne nga fshirja e tyre.

#### **Hua të marra dhe të dhëna**

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimiqit dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferençë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë përiudhës së huamarries duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

## **Top Channel sha**

*(te gjitha vlerat ne Lek, pervec nese nuk shprehet ndryshe)*

### **4. Politikat kontabël (vazhdim)**

#### **4.2. Instrumentat financiare (vazhdim)**

##### **Vlera e drejtë**

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

##### **Të tjera**

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

##### **Kapitali aksionar**

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

##### **Zhvlerësimi i aktiveve financiare**

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### **4.3. Inventarët**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

#### **4.4. Aktive afatgjata materiale**

##### **i. Njohja dhe matja**

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

## **Top Channel sha**

(te gjitha vlerat ne Lek, pervec nese nuk shprehet ndryshe)

### **4. Politikat kontabël (vazhdim)**

#### **4.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)**

##### ***ii. Kostot e mëpasshme***

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

##### ***iii. Amortizimi***

Amortizimi i aktiveve illogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Normat e amortizimit për vitin 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

<b>Kategoria e aktiveve</b>	<b>Metoda e Amortizimit</b>	<b>Norma e Amortizimit</b>
Toka	-	Nuk amortizohet
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Instalime Teknike	Vlera e mbetur	20%
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Te tjera	Vlera e mbetur	20%

Vlera e mbartur e aktiveve afatgjata materiale rishikohen për zhvlerësim kur ngjarje apo ndryshime në rrethanat tregojnë se vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, kur vlera kontabël tejkalon vlerën e rikuperueshme të vlerësuar aktivet paraqiten me vlerën e tyre të rikuperueshme, e cila është më e larta mes vlerës së tyre të drejtë minus kostot për shitje dhe vlerës së tyre në përdorim. Amortizimi nuk aplikohet për tokën dhe punimet në proces që nuk janë në funksionim.

##### ***iv. Çregjistrimi***

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerra e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

### **4.5. Aktivet Afatgjata Jomateriale**

Një aktiv jo-material njihet nëqoftëse, e vetëm nëqoftëse:

- Eshtë e mundshme që përfitimet e pritshme ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktivit do të rrjedhin tek njësia ekonomike; dhe kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri.
- Një njësi ekonomike vlerëson mundësinë e përfitimeve të pritshme ekonomike në të ardhmen duke përdorur supozime të arsyeshme dhe të mbështetura që përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të drejtimit të kompletit të kushteve ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së dobishme të aktivit.
- Njësia ekonomike përdor gjykimin për të vlerësuar shkallën e sigurisë bashkëngjitur flukseve të përfitimeve ekonomike në të ardhmen që i atribuohen përdorimit të aktivit mbi bazën e evidencës së disponueshme në kohën e njohjes fillestare, duke i dhënë më shumë rëndësi evidencës nga të tretët.

Një aktiv jo-material matet fillimisht me koston.

## **Top Channel sha**

*(te gjitha vlerat ne Lek, pervec nese nuk shprehet ndryshe)*

### **4. Politikat kontabël (vazhdim)**

#### **4.5. Aktive afatgjata jomateriale (vazhdim)**

##### **Mbajtja e mëpasshme**

Mbas njohjes fillestare, një aktiv jo-material mbartet me koston e tij minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Aktivet jo-materiale amortizohen me normën 15% mbi koston historike.

#### **4.6. Aktive jo financiare**

Vlerat kontabël të aktiveve jofinanciare të Shoqërisë janë rishikuar në datën e raportimit për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivit. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuara monetare të ardhshme janë zbritur për vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivin për të cilat vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme nuk janë rregulluar.

Humbjet nga zhvlerësimi nijhen në qoftë se vlera e mbartur e aktivit apo pjesa e burimit të parave e kalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në të ardhura ose shpenzime.

#### **4.7. Të ardhurat**

Të ardhurat nijhen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

#### **4.8. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të fitimit/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga zhvlerësimet e aktiveve afatgjate dhe te ardhura nga veprimtari te tjera jooperative.

#### **4.9. Qiratë**

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare nijhen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Pagesat e bëra për qiratë operative nijhen në të ardhura ose shpenzime në mënyrë lineare gjatë afatit të qirasë. Shoqëria ka vetem qira operative.

#### **4.10. Grantet**

Grantet që lidhen me aktivet, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejtë, paraqiten ne pasqyren e pozicionit financiar duke e njohur grantin si të ardhur të shtyrë, e cila nijhet si e ardhur ne Pasqyren e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera te per gjithshme në mënyrë sistematike dhe proporcionale per gjat jetës së dobishme të aktivit.

#### **4.11. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesit nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që nijhen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesit nijhen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesit mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura huamarrjes nijhen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

## **Top Channel sha**

*(te gjitha vlerat ne Lek, pervec nese nuk shprehet ndryshe)*

### **4. Politikat kontabël (vazhdim)**

#### **4.12. Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatushem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 eshte 15% (2018: 15%).

#### **4.13. Fondet për pensione**

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiscale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridikcionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

#### **4.14. Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

#### **4.15. Provizonet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizonet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizonet rimerren.

#### **4.16. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënimë të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënimë për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

#### **4.17. Krahasueshmeria e informacionit kontabel**

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqëris. Ato aplikohen retrospektivisht.

## Top Channel sha

(te gjitha vlerat ne Lek, pervec nese muk shprehet ndryshe)

### 5. Aktivet afatgjata materiale

	Toka	Ndërtesa	Instalime te pergjithshme	Pajisje informatike	Mobilje dhe Pajisje Zyre	Mjete transporti	Të tjera	AAM ne proces	Totali
<b>Kosto</b>									
Gjendja më 1 janar 2018	221,369,378	1,526,037,859	1,040,913,513	74,960,105	258,151,220	156,603,487	3,532,039	4,479,941	3,286,047,542
Shtesa	-	-	10,448,927	512,496	18,732,139	17,905,325	1,024,181	-	48,623,069
Diferenca nga perkthimi k.k	-	-	-	(497,196)	(140,117)	-	-	-	(637,313)
Nxjerje iashtë përdorimi	-	-	-	-	(9,352,765)	-	-	-	(9,352,765)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>221,369,378</b>	<b>1,526,037,859</b>	<b>1,051,362,440</b>	<b>74,975,405</b>	<b>267,390,477</b>	<b>174,508,812</b>	<b>4,556,220</b>	<b>4,479,941</b>	<b>3,324,680,532</b>
Shtesa	-	-	30,152,445	1,606,762	1,576,175	2,865,020	333,325	-	36,553,727
Diferenca nga perkthimi k.k	-	-	-	(86,084)	(24,259)	-	-	-	(110,343)
Nxjerje i/përdorimi	-	-	-	-	(736,011)	(8,516,333)	-	-	(9,252,344)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>221,369,378</b>	<b>1,526,037,859</b>	<b>1,081,514,885</b>	<b>76,496,083</b>	<b>268,144,557</b>	<b>168,857,499</b>	<b>4,889,545</b>	<b>4,479,941</b>	<b>3,351,851,572</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>									
Gjendja më 1 janar 2018	-	168,528,700	792,769,625	62,208,632	130,663,479	124,418,263	1,738,309	-	1,280,327,007
Amortizimi i vittit TR	-	67,875,458	55,584,189	4,378,503	27,127,567	10,172,691	427,347	-	165,565,756
Amortizimi KS&MK	-	-	-	485,862	292,360	-	-	-	778,222
Diferenca nga perkthimi k.k	-	-	-	(377,476)	(227,143)	-	-	-	(604,619)
Kthim Amortizimi	-	-	-	-	(1,542,203)	-	-	-	(1,542,203)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>236,404,158</b>	<b>848,353,814</b>	<b>66,695,521</b>	<b>156,314,060</b>	<b>134,590,954</b>	<b>2,165,656</b>	<b>-</b>	<b>1,444,524,163</b>	<b>-</b>
Amortizimi vittit	-	64,481,685	43,030,421	2,293,433	22,313,790	7,922,339	531,312	-	140,572,980
Amortizimi i vittit K&MK	-	-	-	-	(110,343)	-	-	-	(110,343)
Diferenca nga perkthimi k.k	-	-	-	-	(456,550)	(7,787,561)	-	-	(8,244,112)
Kthim amortizimi	-	300,885,843	891,384,235	68,988,955	178,060,956	134,725,732	2,696,968	-	1,576,742,689
<b>Vlera neto kontabël</b>									
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	221,369,378	1,289,633,701	203,008,626	8,279,884	111,076,417	39,917,858	2,390,564	4,479,941	1,880,156,369
Gjendja më 31 dhjetor 2019	221,369,378	1,225,152,016	190,130,650	7,507,129	90,083,601	34,131,767	2,192,577	4,479,941	1,775,108,883

Shoqeria ka vendosur garanci bankare për transaksionet me palët e treta si më poshtë:

- Toka, ndërtesa, mijete transporti dhe makineri e pajisje janë lënë si kolateral për kreditë dhe overdraftet me Raiffeisen Bank, Union Bank dhe Societe Generale.

## Top Channel sha

(te gjitha vlerat ne Lek, pervec nese nuk shprehet ndryshe)

### 6. Aktivet afatgjata jomateriale

	AAJM	Totali
<b>Kosto</b>		
Gjendja më 1 janar 2018	1,448,189	1,448,189
Shtesa		
Diferencia nga perkthimi k.k		
Nxjerrje jashtë përdorimi		
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>1,448,189</b>	<b>1,448,189</b>
Shtesa		
Diferencia nga perkthimi k.k		
Nxjerrje J/Perdorimi		
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>1,448,189</b>	<b>1,448,189</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>		
Gjendja më 1 janar 2018	414,538	414,538
Amortizimi i vitit TR	217,045	217,045
Amortizimi KS&MK		
Diferencia nga perkthimi k.k		
Kthim Amortizimi		
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>631,583</b>	<b>631,583</b>
Amortizimi vitit		
Amortizimi i vitit K&MK		
Diferencia nga perkthimi k.k		
Kthim amortizimi		
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>841,494</b>	<b>841,494</b>
<b>Vlera neto kontabël</b>		
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>816,606</b>	<b>816,606</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>606,695</b>	<b>606,695</b>

## Top Channel sha

(te gjitha vlerat ne Lek, pervec nese nuk shprehet ndryshe)

### 7. Llogari të arkëtueshme të tjera

Në këtë zë janë hua dhëne palëve të treta , balanca e të cilave më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshte:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Hua e dhënë palëve të treta	3,994,799	4,042,154
	<u>3,994,799</u>	<u>4,042,154</u>

### 8. Inventarë

Balanca e inventarit të shoqërisë më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshte:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Mallra	749,571	3,378,877
Karburant	406,631	547,730
	<u>1,156,202</u>	<u>3,926,607</u>

### 9. Llogari të arkëtueshme tregtare

Gjendja e llogarive të arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Klientë	1,024,022,903	861,251,214
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	(171,174,026)	(126,890,008)
	<u>852,848,876</u>	<u>734,361,206</u>

Levizja ne zhvlerësimin e llogarive te arkëtueshme me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 eshte si me poshte:

	2019	2018
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme		
Gjendja me 1 Janar	(126,890,008)	(95,299,411)
Rimarrje gjate vitit	-	16,498,471
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme gjate vitit	(44,284,018)	(48,089,068)
<b>Gjendja me 31 dhjetor</b>	<b>(171,174,026)</b>	<b>(126,890,008)</b>

### 10. Llogari të arkëtueshme të tjera

Llogaritë e arkëtueshme të tjera të Shoqërisë më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Garanci	815,012	815,012
Të tjera	693,232	1,496,422
	<u>1,508,244</u>	<u>2,311,434</u>

## Top Channel sha

(te gjitha vlerat ne Lek, pervec nese nuk shprehet ndryshe)

### 11. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Në këtë zë jane paraqitur shpenzime të cilat i përkasin periudhave te ardhme për skenografite, të drejta dhe të tjera shpenzime të cilat do të perdoren/shfaqen në periudhat e ardhme.

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Shpenzime të shtyra	77,997,743	47,607,989
Parapagime për furnizime	2,222,328	5,936,284
	<b>80,220,071</b>	<b>53,544,273</b>

### 12. Mjete monetare ne arkë e në banke

Balancat e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si në vijim:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Mjete monetare në bankë	111,095,431	9,342,556
Llogari rrjedhëse	111,095,431	9,342,556
Mjete monetare në arkë	3,642,984	1,532,709
	<b>114,738,415</b>	<b>10,875,265</b>

### 13. Kapitali

